

|                                                                                                                               |                            |                              |
|-------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------------|----------------------------|------------------------------|
| REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO<br>KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ |                            |                              |
| DREJTORIA E ADMINISTRATIVES DHE PERSONELIT • UPRAVA ADMINISTRACIJE I OSOBLJA                                                  |                            |                              |
| Datede / Izlaze: Date / Dana: 04 / 08 / 2025                                                                                  |                            |                              |
| Nr. Orgv<br>Org. jed 09                                                                                                       | Nr. Prot.<br>Br. Prot. 295 | Nr. Faqeve.<br>Br. Strana. 2 |
| Ferizaj - Uroševac                                                                                                            |                            |                              |



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
 KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT

KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA

MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002

E-mail: info.ferizaj@rks-gov.net

Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

## Procesverbal nga dëgjimi buxhetor me komunitetin pakice në Komunën e Ferizajt

Me datën 23 korrik 2025 është mbajtur dëgjimi i gjashtë buxhetor me komunitetin pakicë në Komunën e Ferizajt, në kuadër të procesit të hartimit të buxhetit komunal për vitin 2026.

Ky takim u zhvillua në sallën e Kuvendit të Komunës dhe kishte për qëllim përfshirjen aktive të të gjitha komuniteteve në procesin e planifikimit buxhetor për vitin 2026.

Në këtë dëgjim mori pjesë drejtori i urbanizimit, Arber Bytyqi, i cili i njoftoi të pranishmit për strukturën e projektbuxhetit të vitit 2026, duke shpjeguar planifikimet dhe mundësitë e investimeve të ardhshme në shërbim të qytetarëve. Ai theksoi rëndësinë që ka ky proces për të garantuar pjesëmarrje gjithëpërfshirëse dhe për të adresuar nevojat reale të komuniteteve në nivel lokal.

Pas fjalës hyrëse të drejtorit, fjala ju kaloi të pranishmëve.

Rexhep Bajrami-

- Në rrugën "Ejup Statovci" të bëhet një rrethrotullim ose të vendosen sinjalistika për shkak se çdo ditë ka aksidente në trafik.



REPUBLIKA E KOSOVËS • REPUBLIKA KOSOVO • REPUBLIC OF KOSOVO  
KOMUNA E FERIZAJT • OPŠTINA UROŠEVAC • MUNICIPALITY OF FERIZAJ



<http://kk.rks-gov.net/ferizaj>

ZYRA - KABINETI I KRYETARIT  
KANCELARIJA - KABINET GRADONAČELNIKA  
MAYOR'S OFFICE - CABINET

Tel: 038/200-46002  
E-mail: [info.ferizaj@rks-gov.net](mailto:info.ferizaj@rks-gov.net)  
Adresa: Rr. "Dëshmorët e Kombit" p.n.

- Në fshatin Dubravë të vendosen policë të vdekur për shkak se shpejtësia e automjeteve është shumë e madhe.
- Te shkolla e fshatit Zaskok, të bëhet një rrethrrrotullim për shkak se është një udhëkryq që lidh Zaskokun-Pleshinen dhe Manastricin dhe po ka aksidente të shumta.
- Të bëhen trotualet në rrugën "Ejup Statovci"
- Në rrugën "15 shkurti" nuk ka rrjet elektrik të mirë, duhet të vendoset një trafo e re.
- Mirëmbajtja e varrezave në fshati Dubrave, sepse gjendja është shumë e keqe.

Bajram Bajrami

- Tek ish kompania "Pastërtia", a mund të bëni një fushë sportive në mënyrë që komuniteti të ketë një hapësirë ku mund të zhvillojë aktivitete të tyre rekreative-sportive?

Zyratërt komunal u zotuan se kërkesat e adresuara do të trajtohen me prioritet, sipas mundësive buxhetore dhe nevojave reale të terrenit.

Ky takim ka përfunduar në orën 15:00.